



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 62 prot.

Himarë, më 29.02.2024

**PROCESVERBAL I KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË, ZBARDHUR NGA
ORGJINALI, MBI ZHVILLIMIN E MBLEDHJES PËR MUAJIN SHKURT.**

1. Në mbledhje marrin pjesë këshilltarët:

Elisabeta Lamaj, Dhimitër Kapaj, Thodhori Foto, Mirka Gjiçali, Milto Nika, Aleks Llazari, Silva Burbo, Timoleo Gërdhuqi, Artan Bala, Thëllëza Kokaveshi, Artionil Shirokaj, Maks Vlasi, Miltiadh Prifti.

Mungojnë : Nikolinë Laska (me arsye) ,Afrovita Dhimojani, Loreta Isufi, Nertila Husi, Fuat Mati, Lenica Kocani, Qirjako Mërkuri, Gjergj Iliadhi.

Në mbledhje marrin pjesë të ftuar:

Drejtoritë e drejtorive, administratorët e njësisë të Bashkisë Himarë, kryetarët e fshatrave, banorë.

Sigurohet mbi 50% pjesëmarrja e këshilltarëve.

Mbledhjen e hap Kryetari i Këshillit Z. Dhimitër Kapaj.

3. Miratimi i rendit të ditës.

Kryetari Këshillit:- Jeni dakort me rendin e ditës? **PO** -Këshilltarët.

Miratohet rendi ditës.

Pika 1.

Raporti për vendimmarrjen dhe performancën e këshillit të Bashkisë Himarë.

Znj: Silva Burbo:- nuk kemi informacion mbi marrjen e vendimeve para konstituimit të Këshillit që nga muaji janar, kërkojmë ligjshmërinë ku është miratuar ujësjellësi i Himarës me bashkinë Selenicë – Vlorë.

Sekretarja e këshillit:- këshilli për vitin 2023 ka miratuar një buxhet prej 500 mijë të vjetra të cilin e ka përdorë për një vizitë në kuadrin e shkëmbim eksperiencash me komunën dhe bashkinë Pejë në Kosovë.

Kryetari i Këshillit :- Këshilli Bashkiak nuk ka patur ndonjë buxhet që është për të diskutuar, ne kemi një problem me kryetarët e fshatrave që kemi zgjedhur ku shpërblimi në ligj thotë 10 % të kryetarit të këshillit e cila më parë ka qënë me ligj 10% të administratorit të njësisë.

Drejtori financës Laert Mezani:- është një lapsus të cilët jemi të detyruar të presim deri sa ta rregullojmë.

Z.Timole Gërdhuqi:- çështjen e ujësjellësit ta lëmë për ndonjë mbledhje tjetër për diskutim.

Zyra juridike:- të gjitha vendimet e Këshillit Bashkik Himarë i gjeni në faqen e webit Bashkia Himarë.Përsa i përket ujësjellësit që përmendi Znj.Silva është një vendim i cili është marr nga këshilli i mëparshëm,për herë të dytë erdhi si rivalin.

Z.Timoleo Gërdhuqi:- kërkojmë një mbledhje jashtë radhe për ujësjellësin.

Z.Milto Nila:- ju kërkoj të zbatohet etika e të folurit në këshill,të dëgjojmë dhe të flasim me radhë.

Miratohet materiali mbi raportin e performancës së Këshillit.

Pika 2 .

Shqyrtimi dhe miratimi i komisionit për integrimin evropian të Bashkisë Himarë.

Krupi i këshilltarëve të opozitës propozon kryetar komisioni Thëllëza Kokaveshi,sekretar Timoleo Gërdhuqi.Grupi këshilltarëve të pozitës propozon nënkryetar Artionil Shiroka.

Kryetari këshillit:- Jeni dakort,e miratojmë?

Miratohet vendimi nr.6 me 13 vota pro mbi komisionin e integritit evropian.

Pika 3

Miratohet vendimi nr.7 mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga 6% i bllok- ndihmës për periudhën 1- 31 janar.

Z.Timoleo Gërdhuqi:- Dua të di nga dallon ndihma ekonomike nga ndihma sociale? Pse nuk jepet ndihmë sociale nga Bashkia jonë? Jep shpjegim drejtori financës:- Ka disa kritere për plotësimin dhe dhënien e kësaj ndihme.Ne veprojmë në bazë të ligjit për dhënien e ndihmës ekonomike po ashtu edhe për ndihmën sociale.

Znj.Silva Burbo:- kërkojmë zbardhje vendimi për ndihmën sociale.

Shqyrtimi i kërkesës së Znj.Silva Burbo nga mbledhja e muajit të kaluar ku ngriti shqetësimin se Këshilli i Bashkisë Sarandë ka prekur tokë kullor në territorin e Bashkisë Himarë.

Kryetari këshilli lexon kthimin e përgjigjes nga drejtorja e pyjeve,kullotave.Drejtori Ilirjan Gjika jep shpjegim këshillit në bazë të ligjit .Harta që ju pretendoni Znj.këshilltare është dhënë me vvendim nga Këshilli i ministrave.

Të ndryshme.

Shqyrtimi i kërkesës për shtëpinë e djegur në fshatin Palasë ,banues Klaudio Hoxha.Sqaron drejtori Sokrat Kreku :- drejtorisë time nuk i ka ardhur asnjë shkresë në mënyrë zyrtare për këtë çështje.Sqaron drejtorja juridike:- ju lutem çoni procesverbalin në sekretarinë e Bashkisë, pastaj drejtorja përkatëse do të merret me këtë çështje nga ana ligjore .

Z.Milto Nika:- rruga në Kakome është e zënë dhe e zaptuar nga firma e ndërtimit.

Z.Thodhori Foto:-Kërkojmë restaurimin e rrugës Qeparo fshat .

Mbledhjen e mbyll kryetari këshillit :- mirë u takoheshim në mbledhjen e radhës!

Sekretari

Elena Memushaj

